

#22 



Advocacy Center
for **Democratic Culture**



TETOR
2022

BULETINI



KONFERENCË PUBLIKE


**LUFTA KUNDËR
KORRUPSIONIT**



PANELI

**YLL
BULESHKAJ**
Drejtor i Agjencisë
Kundër Korrupsionit

@ office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com

 Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Prishtina



TA | KOHA

ADRIJA
HO

KONFERENCA MBI KORRUPSIONIN

Më 17 tetor, në ambientet e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicën e Veriut, OJQ ACDC - Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike organizoi konferencën publike mbi korrupsionin. Panelistët ishin Yll Buleshkaj, drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit; Adrijana Hoxhiq, Zëvendëskryetare e Komunës së Mitrovicës Veriore dhe Natasha Nastiq, drejtoreshë e Departamentit të Buxhetit dhe Financave të Komunës së Leposaviqit. Qëllimi i konferencës ishte ngritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e luftës kundër korrupsionit.



Konferenca shërbeu si ngjarje përfundimtare e projektit "Përmirësimi i reagimit institucional ndaj korrupsionit në veri të Kosovës".

SRB ENG

 [Fillimi](#) [Për ne](#) [Lajme](#) [Projektet](#) [Publikimi](#)

Shikoni faqen tonë të internetit për të lexuar më shumë rreth ngjarjes.



Mbahet konferencë publike mbi korrupsionin

Më 17 tetor, në ambientet e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicën e Veriut, OJQ ACDC - Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike organizoi konferencën publike mbi korrupsionin.

TAKIMET E RRJETIT TË GRAVE

OJQ ACDC vazhdoi të organizojë takime me anëtarët e Rrjetit të Grave nga veriu i Kosovës, me qëllim të përmirësimit të drejtave të grave dhe përfshirjes së tyre në vendimmarrje si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror.



Projekti Gratë për gratë - të bashkuara në pushtet, i zbatuar nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), është mbështetur nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes aksionit "Përparimi i Barazisë Gjimore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky Veprim financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim.

Në kuadër të projektit M4Y janë mbajtur trajnime me vullnetarë dhe udhëheqës të projektit në Zveçan, Vushtrri, Skenderaj dhe Ranillug. Trajnimet janë krijuar për t'i pajisur vullnetarët dhe drejtuesit me aftësi specifike të kërkuara për angazhimin e tyre, zbatimin e projektit, raportimin dhe prokurimin.



TRAJNIMET M4Y



KURSI I GJUHES SHQIPE



Me mbështetjen e programit të KCSF-së "EJA Kosovë", vazhduan mësimet e gjuhës shqipe për ekipin e ACDC-së. Objektivi i programit të gjuhës shqipe është të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë gjuhësore të ekipit të organizatës ACDC.



TRAJNIM ME KOMITETET E KOMUNITETEVE



Drejtori i programit të OJQ ACDC, Aleksandar Rapajiq, mbajti trajnim me përfaqësuesit e Komiteteve për Komunitete. Trajnimi kishte për qëllim fuqizimin e Komitetit për të punuar në mënyrë efektive me komunitetet në Mitrovicën e Veriut, për vlerësimin e nevojave të tyre dhe shkrimin/menaxhimin e projekteve.

TRAJNIM PËR PR DHE KOMUNIKIM ME MEDIA



Facebook @ OSCE Kosovo

Me qëllim të përmirësimit të aftësive, njohurive dhe kompetencave të komunikimit publik të përfaqësuesve të organizatave lokale joqeveritare dhe qendrave rinore, nga data 17 deri më 20 tetor 2022, OSBE zyra në Kosovë, organizoi trajnimin: programi për marrëdhëniet me publikun dhe komunikimin me media.

Asistentja e Programit të OJQ ACDC, Snezana Vukiçević, mori pjesë në këtë trajnim, e që u përshtat nevojave të aktivistëve të OJQ-ve dhe punëtorëve rinorë dhe u dha atyre mundësinë për të fituar njohuri praktike dhe mjete që do t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë vizibilitetin e organizatave të tyre dhe aktivitetet promovuese. Trajnere ishte një gazetare dhe edukatore e medias me një përvojë të gjatë, Anamari Repiq.

Dyzet organizata joqeveritare, duke përfshirë ACDC, lëshuan një deklaratë për shtyp për të shprehur shqetësimin për ndikimin e mungesës së progresit në dialogun Beograd-Prishtinë në komunitetet lokale në Serbi dhe Kosovë.

Lexoni deklaratën e plotë në serbisht, shqip dhe anglisht.

SRB

ALB

ENG



PANAIRI I PROJEKTEVE ERASMUS+



Në ngjarjen e organizuar nga Zyra Kosovare Erasmus+ (KEO) për të festuar 35 vjetorin e programit Erasmus+, OJQ ACDC pati mundësinë të promovojë publikime dhe materiale të shumta promovuese si dhe të prezantojë punën e organizatës.



SHPLLJE PUNE



Në tetor, Orgnizata Joqeveritare Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike shpalli thirrjen për aplikime për pozitën e "bashkëpunëtorit ligjor" për të mbështetur Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicën e Veriut. Gjatë këtij muaji janë zhvilluar intervista me kandidatët e mundshëm.

@ facebook.com/natoparliamentaryassembly




SEMINARI #ROSEROTHPRISTINA

Dushan Radakovic, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturën Demokratike mori pjesë në seminarin #RoseRothPrishtina të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-s / Assemblée parlementaire de l'OTAN, ku diskutoi rolin e të rinjve në ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme, demokratike, multietnike dhe paqësore.



Këtë muaj, OJQ ACDC filloi fushatën mediale që synon të promovojë histori pozitive të grave në gjyqësor, polici dhe politikë.


Shikoni historitë e Marija Mishković, juriste, bashkëpunëtore e pavarur juridike në Fakultetin e Mjekësisë dhe konsulente juridike në Zyrën për Ndihmë Juridike Falas, dhe Ines Aljović Mihajlović, kryetare e Komisionit për Komunitete në Komunën e Zveçanit.




Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Yll Buleshkaj, foli për korrupsionin në Kosovë dhe mekanizmat për parandalimin e tij, rolin e Agjencisë dhe bashkëpunimin me institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e masave në luftën kundër korrupsionit, si dhe për mënyrën se si palët e interesuara mund të raportojë korrupsion.



Marija Nedeljković foli për gjyqësorin e integruar nga këndvështrimi i një avokateje të re. Biseda në media shërbeu për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e të rinjve në punën e OSHC-ve dhe institucioneve publike përmes praktikave dhe vullnetarizmit.



Drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, mori pjesë në një debat publik të quajtur "Kujt i duhet Asociacioni i Komunave Serbe?", organizuar nga Iniciativa Qytetare Serbe dhe Iniciativa Qytetare PËR Zubin Potok.



Drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, për procesin e verifikimit të diplomës:



Mbulimi mediatic i konferencës për korrupsionin:

